



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1061_11_13**;
- Ankesa e KEDS-it e datës 16.12.2013.

në seancën e mbajtur më datë 27 dhjetor 2013, nxorri këtë:

V E N D I M

- I REFUZOHET** ankesa e KEDS-it ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin M. B. me shifër të konsumatorit: DPZ – 63833) nga Theranda ndaj vendimit të DMK-së, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK_V_1061_11_13 i datës 21.11.2013.

Arsyetim

Me datë 14.09.2007 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për ndërrim njehsori kanë dal te konsumatori dhe kanë bërë ndërrimin e njehsorit elektrik, ku kanë hequr nga matja njehsorin elektrik nr. 116231 me gjendje: TL=44174 kW (tarifa e lartë) dhe TU=00011 kW, dhe kanë vendosur për matje njehsorin elektrik të KEK-ut me nr. 44192530 me gjendje: TL=00005 kW dhe TU=0005 kW, ku i njëjti njehsor është dërguar në qendrën e kalibrimit për verifikim.

Me datë 06.12.2007 punëtorët e qendrës së kalibrimit kanë bërë kontrollimin detal të njehsorit elektrik nr. 116231, ku është konstatuar se njehsori elektrik (bllombat) shtetërore një e ka në rregull, kapaku i jashtëm është i shpuar me një vrimë më të madhe, në brendi të njehsorit ka pluhur, poashtu njehsori ka frenim mekanik ku edhe është pengua puna e diskut.

Pas verifikimit të gjendjes së njehsorit elektrik KEK me datë 29.03.2008 e ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike me anë të faturës DPZ08HP04185 në vlerë prej 2,716.81€.

Në bazë të ankesës së konsumatorit të datës 18.06.2008, Departamenti për Konsumator në KEK me datë 20.06.2008 i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar dhe duke u thirrur në ankesën e konsumatorit, procedurën për zgjidhjen e ankesave dhe kontesteve në sektorin e energjisë, procesverbalin e kontrollës dhe inspektimit nr. 039580 të datës 20.03.2008, si dhe faturën e rikthimit të humbjeve.



Konsumatori pas përgjigjes së KEK-ut me datë 08.07.2008 ka parashtruar ankesë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE. DMK pas parashtrimit të ankesës së konsumatorit ka bërë shqyrtimin e ankesës dhe me datë 21.11.2013 ka nxjerr vendim duke e **aprovuar** ankesën e konsumatorit dhe duke kërkuar nga KKDFE që të shkarkojë konsumatorin nga fatura e shfrytëzimit të paautorizuar (rikthimit të humbjeve) DPZ08HP04185 të datës 29.03.2008 në vlerë prej 2,716.81€.

Pas marrjes së vendimit të DMK-së, me datë 12.12.2013 KEDS-i ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRRE-së ndaj këtij vendimi, për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes dhe zbatimit të gabuar të dispozitave ligjore.

Baza e kundërshtimeve të KEDS-it të theksuara në ankesë është se DMK e ZRRE-së gabimisht ka bërë vlerësimin e provave dhe shkresave të prezantuara të lëndës për faktin se sektori i kalibrimit e ka konstatuar se njehsori padyshim është keqpërdorur nga ana e konsumatorit dhe është konstatuar se njehsori elektrik është i shpuar dhe se ne brendi ka pluhur dhe ka frenim mekanik, si dhe është konstatua se meqë lënda është ne procedurë gjyqësore komisioni u pajtua që borxhi të kontestohet deri në vendimin e plotfuqishëm të gjykatës. Kundërshtimi tjetër është se nuk është i vetmi argument konstatimi teknik i bërë nga kalibrimi që ka ndikuar në faturimin e rikthimit të humbjeve, por është edhe rrjedha e energjisë elektrike edhe pse mendohet se jo gjithmonë rrjedha e energjisë se shpenzuar është tregues i vërtet se nuk ka manipulim me njehsorin elektrik.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 27 dhjetor 2013 ka analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e KEDS-it, përkatësisht bazën e kundërshtimit, me të cilën pretendohet se DMK, gjatë vendosjes së kësaj çështje nuk ka vlerësuar mirë provat dhe faktet e prezantuara. Bordi i ZRRE-së pas vlerësimit të shkresave të lëndës ka vërejtur se të kjo pikë matëse nuk ka indikacione se është shkaktuar shfrytëzim i paautorizuar i energjisë elektrike. Nga analiza e bërë e rrjedhës se energjisë elektrike duke krahasuar periudhën kohore nga muaji 08/2002 e deri në periudhën kohore 09/2007 kur i është bërë ndërrimi i njehsorit elektrik i njëjti po thuajse në gjithë këtë periudhë kohore është faturuar me faturim pa matje/paushall, duke u faturuar me vlera të ndryshme të paushallit, njëherë me 220 kWh/muaj, pastaj me shpenzim prej 575 kWh/muaj, si dhe me shpenzim prej 573 kWh/muaj, pa bërë matjen e energjisë elektrike të shpenzuar. Në raste të tilla të faturimit paushall nuk mund të ngarkohet me shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike pasi që nuk dihet shpenzimi real se sa është tek ky konsumator, gjithashtu edhe nga ana e KEK për tërë këtë periudhë nuk është dashtë të faturohet paushall.

Bordi i ZRRE-së, gjatë vendosjes se kësaj lënda ka marr për bazë edhe dokumentin e lëshuar nga kryetari i fshatit i cili ka dëshmuar se shtëpia e këtij konsumatori ka qenë pothuajse tërësisht e djegur nga lufta e fundit në Kosovë, andaj si rezultat i gjithë kësaj ka mund të shkaktohen edhe ndonjë dëmtim fizik i njehsorit elektrik, mirëpo lidhur me këtë ka qenë përgjegjësi e vetë KEK, që të intervenoi në sanimin e kësaj gjendje e jo të lihet me vite një gjendje e tillë.

Pretendimet e KEDS, se DMK e ZRRE-së gabimisht ka bërë vlerësimin e provave dhe shkresave të prezantuara të lëndës për faktin se nga qendra e kalibrimit është konstatuar se njehsori elektrik është i manipuluar nga ana e konsumatorit ku kapaku i njehsorit elektrik është i dëmtuar, nuk janë prova bindëse për Bordin duke pasur parasysh faktin se shtëpia në të cilën jeton ky konsumator ka qenë pothuajse tërësisht e djegur dhe si rezultat i kësaj ka pësuar dëmtime edhe njehsori elektrik. Andaj për të mos ardhur tek një situatë e tillë KEK ka qenë e obliguar në bazë të rregullave në fuqi që të largoi atë njehsor nga pika matëse dhe të instaloi njehsorin e ri e jo të lë këtë gjendje me vite të tera.

Sa i përket pikës tjetër të kundërshtimeve nga ana e KEK-ut se përveç konstatimeve nga qendra e kalibrimit është edhe analiza e rrjedhës se energjisë elektrike si bazë e mjaftueshme për ngarkesë me



rikthim të humbjeve, në këtë pikë thuhet se jo gjithmonë rrjedha e energjisë së shpenzuar është tregues i vërtet se nuk ka manipulim në njehsorin elektrik.

Bordi i ZRRE-së, konsideron se konstatimet e tilla nga ana e KEK-ut nuk qëndrojnë pasi që nga analiza e bërë rrjedhës se energjisë elektrike na del se te ky konsumator nga fillimi i faturimit kemi një shpenzim përfaqësues të njëjtë të energjisë elektrike do të thotë para dhe pas ndërrimit të njehsorit elektrik e që kjo është një argument i çart se ky konsumator ka një mesatare të njëjtë të shpenzimit të energjisë elektrike dhe nuk ka elemente të shfrytëzimit të paautorizuar. Me këtë rast kemi të bëjmë edhe me një kontradiktë nga ana e KEK, lidhur me kundërshtimet e tyre të theksuara në ankesë pasi që në një rast thuhet se bazë për ngarkesën e rikthimit të humbjeve është marr edhe rrjedha e energjisë elektrike ndërsa në anën tjetër thuhet se nuk mund edhe t'i besojmë konstatimeve të tilla tek rastet e shfrytëzimit të paautorizuar.

Po ashtu nga rrjedha e energjisë elektrike shihet se konsumatori pasi që është faturuar me vlera paushallë më të larta se sa shpenzimin që ka krijuar të njëjtit i janë bërë korrigjime të herë pas herë, ky fakt tregon se KEK nuk ka bërë një faturim të saktë mujor për këtë pikë matëse si dhe gjithashtu nuk ka bërë një lexim të rregullt mujor ashtu siç përcaktohet me Procedurën e leximit dhe faturimit.

Sipas dokumenteve të prezantuara vërehet se njehsori elektrik i konsumatorit nr. 116231 është prodhim i vitit 1985, dhe se nuk ka asnjë evidencë se kur është vendosur ky njehsor elektrik apo se i është bërë ndonjëherë kontrollimi teknik (kalibrimi) këtij njehsori nga data e prodhimit e deri te data e kontrollimit teknik-kalibrimit të datës 06.12.2007.

Mbështetur në nenin 8 paragrafi 8.3 të Procedurës për Identifikimin dhe Parandalimin e Shfrytëzimit të Paautorizuar të Energjisë Elektrike theksohet: *Konstatimet e parregullsisë funksionale të njehsorit elektrik siç përcaktohet në nenin 3 paragrafi i) të konstatuara në laboratorin e kalibrimit nuk mund të përdoren si provë e vetme meritore për ngarkimin e konsumatorit me faturën e rikthimit të energjisë së humbur.*

Bordi i ZRRE-së ka vlerësuar se KKDFE në ankesën e tij nuk ka prezantuar asnjë provë të vetme me të cilën e vërteton faktin se vendimi i DMK-së nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligj, andaj si të tilla nuk paraqesin bazë të mjaftueshme për prishjen e këtij vendimi.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 27.12.2013 ka analizuar ankesën e konsumatorit dhe vendimin e nxjerr nga DMK nr. ZRRE/DMK_V_1061_11_13, dhe pas analizimit të hollësishëm të të gjitha dëshmive tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërpunueshmërisë në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar